



Datë: 23.01.2026

Numër Protokolli: 371/2026

A.nr.1960/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës—Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje: Arben Mehmeti-kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Malsore Gashi Bajraktari anëtarë, me Flakron Gashi, në cilësi të procesmbajtësit, duke vepruar sipas ankesës me numër A.nr.1960/2025, të datës 27.11.2025, të parashtruar nga ankuesi, H.B nga Prishtina, kundër organit të punësimit/Zyrës së Kryeministrit të Kosovës, në çështjen juridike “*shkelje e të drejtës në pagë*” në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3, dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 23.01.2026, me shumicën e votave mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e parakohshme ankesa me numër A.nr.1960/2025, e datës 27.11.2025, e parashtruar nga ankuesi H.B.

A r s y e t i m

Nëpunësi civil, H.B (*në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesi*), i punësuar në Zyrën e Kryeministrit të Kosovës, më datë 27.11.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për kategorizimin e pozitës në Profesional 2, apo në ekuivalencë me koeficientin G5/5.3 të pagës sipas ligjit të ri të pagave.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, më datë 05.12.2025 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Komunën e Lipjanit, ndërsa kjo e fundit, më datë 09.12.2025, ka përcjell shkresat e lëndës lidhur me çështjen për vendosje.

Kryetari i Këshillit, me datë 23.12.2025 ka nxjerrë Vendimin me shifër VK/2025 dhe numër protokolli:8048/2025, përmes të cilit ankesës së ankuesit nën shenjë A.nr.1960/2025 të datës 27.11.2025 ia ka vazhduara afatin e vendimmarrjes edhe për dhjetë (10) ditë të tjera, ditë pune.

Kolegji i Këshillit nga analizimi i shkresave të lëndës si dhe referuar pretendimeve ankimore të parashtruara nga ankuesi, konstatoi se ankesa **është e parakohshme**, sepse:

Nga shkresat e lëndës rezulton se ankuesi është i punësuar në Zyrën e Kryeministrit të Kosovës dhe se i njëjti sipas Akt të Emërimit me numër 01 Nr.265/2020, të datës 13.11.2020, mban pozitën e punës “Zyrtar i transportit”, në kuadër të Administratës Qendrore/Njësia e Transportit.

Më tej, nga shkresat e lëndës, rrjedhë se ankuesi pas hyrjes në fuqi të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, është duke realizuar pagën sipas klasës “Profesional 3” G6, me koeficient 4.3, ndërsa në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se pozita e tij duhet të klasifikohet në kategorinë Profesional 2, me koeficientin G5/5.3 sipas ligjit të ri të pagave.

Lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore të ankuesit, Kolegji i Këshillit analizoi dispozitat e Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, i zbatueshëm nga data 05.02.2023, përkatësisht nenin 2, paragrafi 1, në lidhje me fushëveprimin ku parashihet se: ”1. Ky ligj zbatohet për të punësuarat/it në sektorin publik pagat e të cilave/ëve financohen nga dhe përmes buxhetit të shtetit, 2. Rregullat dhe kushtet për përcaktimin e pagës të të punësuarave/ëve në sektorin publik janë ekskluzivisht rregullim i këtij ligji dhe mund të rregullohen edhe me akte të tjera nënligjore, vetëm kur parashihet shprehimisht nga ky ligj”, dhe nenin 14, paragrafi 3, të këtij ligji ku përcaktohet se: 3. Klasifikimi i një pozite të caktuar të shërbimit civil, bëhet në bazë të rregullave të vlerësimit dhe klasifikimit të pozitave të punës, sipas dispozitave për klasifikimin e pozitave të shërbimit civil, në pajtim me legjislacionin në fuqi për zyrtarët publik, dhe rrjedhimisht, referuar këtij përcaktimi ligjor, Kolegji i Këshillit konstatoi se paga bazë e nëpunësit civil përcaktohet sipas klasës së pagës, përkatësisht koeficientit, të cilit i përket pozita e punës, e klasifikuar në shtojcën Nr.10 të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, ndërsa klasifikimi i një pozite të caktuar të shërbimit civil, bëhet në pajtim me legjislacionin në fuqi për zyrtarët publik dhe rregulloren e aplikueshme për klasifikimin e vendeve të punës në Shërbimin Civil.

Kolegji i Këshillit, nga analizimi i shkresave të lëndës, ka konstatuar se organi i punësimit, gjegjësisht Zyra e Kryeministrit të Kosovës, ende nuk e ka përfunduar procesin e klasifikimit të vendeve të punës për nëpunësit civil në kuadër të këtij institucioni, dhe se procedimi i pozitës së ankuesit në sistemin e ri të pagave, të krijuar sipas Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, nuk është si pasojë e klasifikimit të pozitës së saj të punës, në kuptim të ligjit material, gjegjësisht Ligjit përkatës për Zyrtarët Publikë dhe Rregullores përkatëse për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, por si rezultat i zbatimit të Vendimit Nr.04/128 të datës 16.02.2023, të Qeverisë së Kosovës lidhur me ekuivalencën e sistemit të vjetër me sistemin e ri të klasifikimit të koeficienteve me qëllim të llogaritjes së pagës bazë.

Andaj, duke qenë se organi përkatës i punësimit në këtë rast Zyra e Kryeministrit të Kosovës, nuk ka përfunduar procesin e klasifikimit të vendeve të punës sikurse përcaktohej me dispozitat e Rregullores (QRK) Nr.06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, në fuqi nga data 28.02.2024, Kolegji i Këshillit vlerëson se ankesa e parashtruar nga ankuesi, për kategorizimin e pozitës së tij sipas kategorisë Profesional 2, është e parakohshme, dhe si e tillë, në këtë fazë nuk i plotëson kushtet ligjore për trajtim meritior. Rrjedhimisht, e njëjta është e papranueshme në kuptim të nenit 129 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Theksuar si me sipër, Kolegji i Këshillit, vlerëson se vetëm pas përfundimit të procesit të klasifikimit të pozitive të punës nga organi përkatës i punësimit, sipas procedurës se theksuar më lart, ankuesit do t'i lindë e drejta e kundërshtimit dhe ankesës për klasifikimin e pozitës së tyre të punës.

Kështu që, në mbështetje të nenit 18, paragrafi 1, nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Ky vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIQËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda:A.nr.1960/2025, datë 23/01/2026

Flakron GASHI

Procesmbajtës

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit H.B;
- Zyra e Kryeministrit të Kosovës (Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore), si dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.